



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: ” RIKUALIFIKIM URBAN BLOK PALLATESH, RRUGA ISUF SOKOLI”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: Kodi

45211360-0 - Punime ndërtimi për zhvillim urban, 45212353-5 - Punime ndërtimi për pallate

VLERA E FONDIT LIMIT: 58,966,835(Pesedhjetë e tetemilion e nentëqind e gjashtedhjetë e gjashtëmijë e teteqind e tridhjetë e pese) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe ne mbështetje te Nenit 26"Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhës te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe si dhe ne Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", te ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020-2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht **58,966,835**(Pesedhjetë e tetemilion e nentëqind e gjashtedhjetë e gjashtëmijë e teteqind e tridhjetë e pese) lekë pa tvsh

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”,*”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **58,966,835**(Pesedhjetë e tetemilion e nentëqind e gjashtedhjetë e gjashtëmijë e teteqind e tridhjetë e pese) lekë pa tvsh që është sa vlera e fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2023 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2023.

Kriteri konsiderohet i permbyshur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **29,483,417** (Njëzet e nentemilion e katerqind e tetëdhjetë e tremije e katerqind e shtatëmbëdhjetë) lekë dhe që

është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **117,933,670** (Njëqind e shtatëmbëdhjetemilion e nentëqind e tridhjetë e tremije e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë)

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
- Fature tatimore perkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4.. *ne lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të pershtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ...Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së*

bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndermjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 39, pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), ., Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 ”Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit “ të ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudimit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike,

qe Autoriteti Kontraktor te bindet qe operatori ekonomik me ane te dokumentacionit te paraqitur ploteson kriterin per pune te ngjashme ku shihen zerat e punimeve qe ka realizuar , koha e realizimit , dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te objektit si dhe vleresimi i dhene nga Autoriteti Kontraktor,elemente te nevojshem per te gjykuar per plotesimin e kriterëve per pune te ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi ne toke”

Kategoria NP-3 Niveli B “Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile civile dhe industriale,veshje fasada.

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge, autostrada, mbikalime...”

Kategoria NP-7 Niveli A “ Ujesjellesa , gazsjellesa ,vajsjellesa vepra kullimi dhe vaditje

Kategoria NP-11 Niveli A “Ndertime per N/Stacionet kabinat e transformatoreve..”

Kategoria NP-12 Niveli A “Punime te inxhinierise se mjedisit”

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndertimeve ...”

Kategoria NS-6 Niveli A “Sinjalistike rrugore jo ndriçuese”

Kategoria NS-18 Niveli A “ Punime topogodezike”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit

teknik. Ai duhet te sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.." Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve te ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi	Punimet ne preventive zeri nr 2,3 KapI ,zeri nr 1,2KapII,zeri nr 1,2Kap III,zeri nr 1,2Kap IV,	Niveli A	1,327,975 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-3</u>	Rik dhe M/M godina civile...	Punimet ne preventiv zeri nr (1-6)Kap VIII	Niveli B	26,378,721
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge, autostrada ,mbikalime....	Punimet ne preventiv,zeri nr (4-17) Kap I	Niveli A	16,753,547 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-7</u>	Ujesjellesa ,gazsjellesa,vajsjellesa	Punimet ne preventiv ,zeri nr (3-10) Kap II,zeri nr (3-9)Kap III,zeri nr (3-10) KapIV,	Niveli A	7,539,585 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-11</u>	Ndertime per N/Stacionet,linja te tensionit te larte dhe te mesem...	Punimet ne preventiv,zeri nr (1-13) Kap V	Niveli A	2,211,998 leke pa tvsh

<u>Kategoria NP-12</u>	Punime te inxhinierise se mjedisit	Punimet ne preventiv ,zeri nr (1-7) kap VI	Niveli A	2,716,048 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-1</u>	Punime per prishjen e ndertimeve	Punimet ne preventiv,zeri nr (1) Kap I	Niveli A	70,180 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-6</u>	Sinjalistike rrugore jo ndriçuese	Punimet ne preventiv,zeri nr (1-2) Kap VII	Niveli A	251,300 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike		Niveli A	

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te paktën:

- 1(nje)inxhinier ndertimi
- 1(nje)inxhinier elektrik
- 1(nje)Inxhinjer topograf, rilevime inxhinierike
- 1(një) Inxhinier Mjedisi

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të siguar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatase E-Sig për të paktën **muajin e fundit**

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës, Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar

Eshtë kërkuar inxhinier elektrik për zbatimin e punimeve ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit ,projektit, specifikimeve teknike qe do te zbatohen Punimet ne preventiv,zeri nr (1-13) Kap V dhe si dhe kategorive perkatase ne licencen perkatase te zbatimit,Inxhinieri ndertimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të projektit për secilin nga zërat e punimeve.Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve qe vendosen ne objekt Kerkohet 1(nje)Inxhinjer topograf per te realizuar rilevime inxhinierike ne terren, 1(një)

Inxhinier Mjedisi pasi ne preventive do zbatohen punimet zeri nr (1-7) kap VI jane punime qe lidhen drejteperdrejte me disponimin e inxhinierit te mjedisit.

- 2.3.4** Vetdeklarimin nga inxhinieri ndertimit , topograf, mjedisit dhe elektrik se ata jane te disponueshem per realizimin e kesaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020”Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP”

- 2.3.5** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ne nenin 39, pika 6, gërma c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar,pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010”Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier"

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e

punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

- 2.3.6** Operatori/et ekonomik duhet të ketë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën **muajin e fundit** (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë").

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa për *Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për **muajin e fundit** duhet të jetë **48 (Dyzet e tete)**.

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhën e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

Numri i punonjësve 48(dyzet e tete)

Afati 6 (gjashte) muaj

Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $84780:8:132=80$ puntore .

Vendosim te kerkojme 44(dyzet e kater) puntore

Nevojiten:

1-Teknik ndertimi nevojitet per drejtimin e punimeve ne objekt

2-Manovrator

3-Shofer

Totali 48(Dyzet e tete) punonjes

- 1- Puntore ndertimi rrugor nevojitet per kryerjen e punimeve te ndertimit te shtresave rrugore ne objekt si shtrese çakulli dhe stabilizanti. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $2860 :8:132= 2,7$ puntore.
- 2- Asfaltoshtuesi nevojitet per ndertimin e shtreses se binderit dhe A/B.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $:246:8:132=0.23$ puntore.
- 3- Muratori nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit si ndertim struktura te ndryshme betoni dhe shtrese pllakash ne trotuare dhe punime suvatimi sipas zerave te preventivit .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $66,847:8:132= 63*30\%=19$ muratore.(19 specialista+10 ndihmesa)
- 4- Elektriçisti nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike ne objekt.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $1006:8:132=0.95$ puntore.
- 5- Hidrauliku nevojitet per kryerjen e punimeve hidraulike ne objekt.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $247:8:132=0.23$ puntore
- 6- Puntore gjelberimi nevojitet per kryerjen e punimeve te gjelberimit ne objekt.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $1395:8:88=1.32$ puntore.
- 7- Hekurkthyes nevojitet per pregaditjen e hekurit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $:432:8:132=0.4$ puntore.
- 8- Bojaxhiu nevojitet per kryerjen e punimeve te bojatisjes.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $:4774:8:132=4.5$ puntore (3bojaxhi+2ndihmesa)
- 9- Marangozi nevojitet per vendosjen e stolave ne objekt.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $66:8:132=0.06$ puntore.

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), diplome leshuar nga autoritetet pergjegjese shtetërore/organe/institute te akredituar, ose te kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate ne rastin kur makinerite jane me qera per manovratorët, ku nga këta të jenë të paktën:

Teknik ndertimi	1(punonjes)
Murator	3(tre) punonjes
Elektracist	1(nje) punonjes
Asfaltoshtrues	1 (nje) punonjes
Hidraulik	1(nje) punonjes
Hekurkthyes	1(nje) punonjes
Bojaxhi	2(dy) punonjes
Marangoz	1(nje) punonjes
Manovrator	2(dy) punonjes

Për stafin teknik të mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës te vlefshme;
- diplomën e shkolles/deshmi nga organe/institute te akredituar që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjesve te mësipërm;
- Manovratorët duhet të jenë punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda(Eskavatorist) dhe (Automakinist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- Asfaltoshtruesi nevojitet per ndertimin e shtreses se binderit dhe A/B.
- Muratorët nevojiten per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit si ndertim struktura te ndryshme betoni dhe shtrese pllakash ne trotuare dhe punime suvatimi sipas zerave te preventivit
- Elektriçisti nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike ne objekt.
- Hidrauliku nevojitet per kryerjen e punimeve hidraulike ne objekt.
- Hekurkthyes nevojitet per pregaditjen e hekurit.

- Bojaxhite nevojiten per kryerjen e punimeve te bojatisjes.
- Marangozi nevojitet per vendosjen e stolave ne objekt.

Vendosja e ketyre kriterëve per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne si dhe mjeteve te kerkuara per zbatimin me sukses te kesaj kontrate.

Te gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Kerkesa per deshmitë e manovratoreve bazohet ne Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi I përdorimit të makinerive të ndërtimit”

2.3.9 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti veteshkarkues mbi 7 ton (kapac.mbjates)	2 copë
2	Mjet transporti me ngarkese deri ne 3 ton	1 copë
3	Autovinc me kosh	1 copë
4	Matrapik	1 copë
5	Betoniere 1-2 m3	1 copë
6	Grejder	1 cope
7	Rrul per ngjeshje asfalti	1 cope

8	Autobitumatrice	1 cope
9	Asfaltoshtruese	1 cope
10	Rrul per ngjeshje cakulli	1 cope
11	Eskavator me goma 0.25 m3	1 cope
12	Skeleri	2000m2
13	Vinc kulle	1 cope
14	Autobot uji	1 cope
15	Minifadrome	1 cope

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Periudha e garancise per defektet eshte 2 vjet pas marrjes ne dorezim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikates)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

Eskavatori me gome nevojitet për germim dhe në punimet rrugore në preventiv zeri nr 2 Kap I punime rrugore.

-Mjeti i transportit vetshkarkues nevojitet për transportin e materialeve të ndertimit si dhëra ,inerte ,binder dhe A/B sipas zerave të preventivit.

Autovinci me kosh nevojitet për vendosjen e kraheve të ndricuesve dhe ndricuesat sipas zerave të preventivit, në preventiv zeri 2 kap V .

Matrapiku nevojitet për prishjen e trotuarit ekzistues sipas zerave të preventivit, në preventiv kap punime ndertimore zeri nr 1Kap I.

Betoniera nevojitet për prodhimin e llaceve dhe betoneve sipas zerave të preventivit,në preventiv zeri 10,12,16 kap I

Grejderi nevojitet për nivelimin e nenshtresave rrugore sipas zerave të preventivit,në preventiv zeri nr 4,5,6,7 Kap I

Rruli për ngjeshje çakulli nevojitet për ngjeshjen e shtresave rrugore sipas zerave të preventivit ,në preventiv zeri nr 4,5,6,7 Kap I

Rruli për ngjeshje asfalti nevojitet për ngjeshje binderi dhe A/B,në preventiv zeri nr 8,9 Kap I.

Autobitumetricja nevojitet për lagjen me bitum të shtresës së stabilizantit sipas zerave të preventivit,në preventiv zeri nr 7 Kap I

Asfaltoshtuesja nevojitet për hapjen në rrugë të shtresës së binderit dhe A/B sipas zerave të preventivit,në preventiv zeri nr 8,9 Kap I.

Skelerite nevojiten për kryerjen e punimeve të suvatimit dhe bojatisjes në preventiv zeri nr 1,2 Kap VIII

Vinc kulle nevojitet për kryerjen e punimeve të suvatimit dhe bojatisjes në preventiv zeri 1,2 Kap VIII

Minifadroma nevojitet për kryerjen e punimeve të germimit dhe ngarkimit në mjet në objekt ku nuk ka mundësi të punojë eskavatori sipas zerave të preventivit,zeri nr 1,2 Kap I,zeri nr 1,2 Kap II,zeri nr 1,2Kap III,zeri nr 1,2KapIV.

Mjet transporti vetshkarkues mbi 7 ton (ngarkesa)

Transport dhëra $2185 \text{ m}^3 \cdot 1.6 = 3496 \text{ ton}$

Transport inerte $1621 \text{ m}^3 \cdot 1.8 = 2918 \text{ ton}$

Transport A/B- 244 ton

Transport materiale të ndryshme -50 ton

Totali 6708 ton : $132 = 51 \text{ ton}$,mesatarisht 8 rrugë në ditë (2 mjete me nga 4 rrugë në ditë)

Periudha e garancise per defektet eshte 2 vjet pas marrjes ne dorezim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikates)

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar pasi periudhe e garancise se punimeve referuar ketij ligji shon nga 1 deri 2 vite

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.